



## Kërkesa për pjesëmarrje në programin për faljen e borxhit publik

Programi për faljen e borxhit është në vazhdimësi në mes 2 Shtatorit 2015 deri me 2 Shtator 2016. Gjatë kësaj periudhe kohore një tatimpagues mund të përfitoj lehtësime për ndëshkime dhe interes të papaguar nëse shuma e plotë që i përket tatimit bazë i paguhet Administratës Tatimore në Kosovë (ATK), ose nëse hynë në marrëveshje fiton lirim të ndëshkimeve.

ATK është përgjegjëse për të siguruar që tatimpaguesit janë të pajisur me informacionin e duhur lidhur me shumën e pagesave të kërkuara, duke përfshirë edhe çdo dispozitë të çdo dokumenti të nevojshëm për të bërë pagesën.

1. Nga falja e borxheve publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, sipas këtij ligji përfitojnë të gjithë personat të cilët kanë obligime të pashlyera ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, me kusht që të njëjtit:

1.1. Të kryejnë pagesën e plotë të obligimeve për periudhën nga 1 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, atëherë personat e këtillë, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit për periudhën 1 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, ose;

1.2. Të lidhin marrëveshje me Institucionin Shtetëror apo Ndërmarrjen Publike për pagesën e borxheve me këste për periudhën 1 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014. Në rastin kur arrihet marrëveshja sipas nën-paragrafit 1.2 të këtij neni, atëherë personat e këtillë, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe faljen e ndëshkimeve për periudhën 1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Pagesa e borxhit sipas këtij paragrafi duhet të kryhet:

1.2.1. brenda afatit prej dy (2) vitesh, për personat juridikë, nga data e lidhjes së marrëveshjes;

1.2.2. brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga personat fizikë, nga data e lidhjes së marrëveshjes.

I lexova dhe i kuptova kriteret e mësipërme dhe dua t'a shfrytëzoj rastin që të marr pjesë në programin për faljen e borxhit publik.

Dua të paguaj tatimin bazë të akumuluar me pagesë të plotë.

Dua të paguaj tatimin bazë, gjobat dhe interesin e akumuluar me marrëveshje.

Numri Fiskal i kompanisë / NP. \_\_\_\_\_

Emri i Plotë i kompanisë / NP. \_\_\_\_\_

Emri i përfaqësuesit të kompanisë/NP. \_\_\_\_\_

Numri i ID i përfaqësuesit të kompanisë/NP. \_\_\_\_\_

Nr.tel. kontaktues \_\_\_\_\_

Data e lindjes \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i përfaqësuesit të kompanisë /NP. \_\_\_\_\_

**Datë:** \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_